



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.167**

**15 dhjetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.933, datë 17.11.2010	Për përcaktimin e procedurave të shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masës së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991 .....	8635
Vendim i KM nr.942, datë 17.11.2010	Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura.....	8649

**VENDIM**  
**Nr.933, datë 17.11.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË KËRKESAVE DHE MASËS SË DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR FAMILJARËT E VIKTIMAVE TË EKZEKUTUARA PADREJTËSISHT, PA GJYQ, PËR MOTIVE POLITIKE, GJATË PERIUdhËS 30.11.1944 DERI MË 1.10.1991**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe paragrafit të tretë të nenit 2 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Ministria e Drejtësisë kryen shqyrtimin administrativ të kërkesave për dëmshpërblim financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991 dhe përcakton masën e dëmshpërblimit financiar, si më poshtë vijon:

I. Procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesave

A. Fillimi i shqyrtimit të kërkesave

1. Ministria e Drejtësisë shqyrton kërkesat për dëmshpërblim financiar, të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike.

2. Afati i paraqitjes së kërkesave të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, është deri 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Mosparaqitja e kërkesës brenda këtij afati sjell humbjen e të drejtës së dëmshpërblimit për familjarin e viktimës së ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike.

3. Me “ekzekutim padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike”, në kuptim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, si dhe të këtij vendimi, për efekt të dëmshpërblimit financiar, kuptohet humbja e jetës, si pasojë e ekzekutimit, pa një vendim gjykate të formës së prerë, pa një akt administrativ apo urdhër hetuesie, për shkak të një vepre penale politike, të listuar në nenin 5 të këtij ligji, gjatë periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991.

4. Familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, paraqesin në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën, me shkrim, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, sipas formularit të aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Formulari i paraqitur në aneksin A, së bashku me formularin tip shpërndahen pranë çdo filiali të Postës Shqiptare sh.a., sipas nenit 21 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

5. Kërkesa paraqitet nga paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e viktimës së ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave. Familjarët në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.

6. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) të dhëna për përbërësit e gjendjes civile të viktimës së ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, në kohën e ekzekutimit;

b) të dhëna për kohën e ekzekutimit;

c) aktin administrativ apo dokumentin zyrtar, të lëshuar gjatë periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991, që provon ekzekutimin pa gjyq, për motive politike;

ç) certifikatën e vdekjes së viktimës së ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike dhe certifikatën e trungut familjar;

d) dokumentacionin që provon lidhjen familjare të dërguesit me viktimën e ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, si dhe dokumentacionin që provon se cilët nga familjarët përfitues janë të gjallë;

dh) çdo informacion, lidhur me gabimet ortografike apo materiale të përbërësve të gjendjes civile të viktimës së ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, për identifikimin e saktë të tij;

e) një adresë të saktë, të zgjedhur për komunikim.

Certifikatat e lindjes duhet të jenë lëshuar jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës.

7. Kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar përcillen pranë Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a. dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, për dërguesin me vendndodhje jashtë vendit, sipas parashikimeve të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

8. Pas regjistrimit të dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 6, të këtij vendimi, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për përfitimin e dëmshpërblimit financiar.

#### B. Shqyrtimi i kërkesës

1. Çdo kërkesë i nënshtrohet, paraprakisht, hetimit administrativ në sektorin e gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë (skedarët e përgjithshëm dhe ata të posaçëm për të përndjekurit politikë të regjimit komunist).

2. Pas verifikimit të drejtpërdrejtë të informacionit, kur provohet se Ministria e Drejtësisë nuk ka të dhëna për kërkuesin, kërkesa i përcillet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit për verifikim të drejtpërdrejtë në burimet e tyre arkivore të periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991.

3. Autoritetet përgjegjëse, brenda afatit 30-ditor nga depozitimi i dosjes, njoftojnë me shkrim, Ministrin e Drejtësisë dhe i përcjellin, bashkëlidhur, një kopje të dokumenteve përkatëse arkivore.

Përgjigjja e autoriteteve përgjegjëse është sipas tekstit në vijim:

“Pas shqyrtimit të kryer në burimet arkivore të institucionit tonë, në bazë të nenit 27, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.933, datë 17.11.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masës së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991”, ju vëmë në dijeni se subjekti kërkues:

a) është ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, në vitin \_\_\_\_\_;

b) nuk ka të dhëna.”.

Kur është e mundur, autoritetet përgjegjëse japin të dhëna edhe për veprën penale politike, për kryerjen e së cilës viktimja është ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq.

4. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e përgjigjes, shfrytëzojnë burimet e tyre arkivore, të krijuara para datës 1.10.1991, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, tregojnë të dhëna për rrethanat e ekzekutimit pa gjyq të viktimës për një vepër penale politike, të listuar në nenin 5 të ligjit nr.9831/2007, të ndryshuar.

5. Informacionet e bashkërenduara depozitohen në dosje. Punonjësi përgjegjës, në përputhje me nenin 28 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, përgatit relacionin, të cilin ia paraqet Ministrit të Drejtësisë.

6. Në rast se, nga verifikimi i autoriteteve përgjegjëse në burimet e tyre arkivore të periudhës 30.11.1944 - 1.10.1991, nuk disponohen të dhëna për kërkuesin, atëherë punonjësi përgjegjës i propozon ministrit ta klasifikojë kërkesën si të pabazuar në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim, për mungesë provash.

7. Klasifikimi si i pabazuar në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim, për mungesë provash, bëhet edhe për rastet kur dosja përmban si dokument provues vendimin e komisionit trepalësh apo vërtetimin e faktit të vrasjes pa gjyq, të dhënë me vendim gjyqësor, të lëshuar pas datës 1.10.1991.

8. Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të propozimit të strukturës përgjegjëse, urdhëron pranimin apo refuzimin e saj, i cili është i formës së prerë.

## II. Përlllogaritja e masës së dëmshpërblimit financiar

1. Familjarët e viktimave të pushkatuara pa gjyq, për motive politike, për vuajtjen dhe persekucionin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 (tetë) viteve kompensim dënimi me burgim. Kompensimi financiar kryhet në bazë të përlllogaritjes sipas së cilës, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer në burg, dëmshpërblimi financiar është në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë. Nga shuma që çdo subjekt i ekzekutuar pa gjyq, për motive politike, përfiton nga ky vendim, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

2. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Entin Kombëtar të Banesave dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bëjnë përlllogaritjet e masës së dëmshpërblimit financiar, në përputhje me pikën 1 të këtij kreu dhe me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1253, datë 2.7.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfituar nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”.

## III. Autoriteti përgjegjës për miratimin e dëmshpërblimit financiar

1. Këshilli i Ministrave është autoriteti përgjegjës që miraton dëmshpërblimin financiar dhe, me vendim, përcakton gjenealitetet përkatëse të të ekzekutuarit padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, mënyrën e ekzekutimit dhe shumën e dëmshpërblimit financiar, gjenealitetet e sakta të familjarëve dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit të tyre.

2. Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që shqyrton kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, sipas ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, dhe të këtij vendimi. Kur, pas shqyrtimit administrativ, rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe në këtë vendim, Ministri i Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e dëmshpërblimit financiar.

3. Këshilli i Ministrave shqyrton propozimet e dërguara nga Ministri i Drejtësisë brenda dy javëve kalendarike. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.

4. Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion, shpërndan fondet në mënyrë proporcionale për të gjithë familjarët e viktimave të pushkatuara, pa gjyq, për motive politike, me kusht që vlera e dëmshpërblimit, gjatë fazës së parë, të mos jetë më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë dhe jo më e vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë.

5. Shuma e llogaritur transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues bëhet nga Ministria e Financave, në llogaritë personale të këtyre përfituesve, të hapura në bankat e nivelit të dytë, të përzgjedhura sipas nenit 33 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

6. Mbikëqyrja e mënyrës së shpërndarjes së çdo dëmshpërblimi kryhet sipas dispozitave të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

IV. Kërkesat për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, të paraqitura pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shqyrtohen sipas procedurave të këtij vendimi. Për këtë qëllim struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, fillon menjëherë shqyrtimin administrativ të kërkesave të depozituara.

V. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit, drejtori i Entit Kombëtar të Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*(Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

**ANEKSI A**

**KËRKESË**

Foto



Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*(Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

## SEKSIONI I

Të dhëna të sakta për identitetin e të ekzekutuarit padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike.  
(bashkëlidhni kopje të certifikatave)

a) Identiteti i saktë zyrtar në kohën e ekzekutimit

1. Emri: \_\_\_\_\_

2. Mbiemri: \_\_\_\_\_

3. Atësia: \_\_\_\_\_

4. Mëmësia: \_\_\_\_\_

5. Seksi:      F    M   

6. Datëlindja: \_\_\_\_\_  
(dita /muaji / viti)

7. Vendlindja: \_\_\_\_\_  
Fshati / komuna/rrethi

8. Vendbanimi: \_\_\_\_\_  
Fshati/komuna/rrethi (ditën e dënimit)

b) Informacion për gabime ortografike apo materiale në përbërësit e gjendjes civile në akte zyrtare;

1. Emri: \_\_\_\_\_

2. Mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*(Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

3. Atësia: \_\_\_\_\_

4. Mëmësia: \_\_\_\_\_

5. Seksi: F/M

6. Datëlindja: \_\_\_\_\_  
(dita /muaji / viti)

7. Vendlindja: \_\_\_\_\_  
Fshati / komuna/rrethi

8. Vendbanimi: \_\_\_\_\_  
Fshati/komuna/rrethi (ditën e dënimit)

c) Ndryshime të mëvonshme në përbërësit e gjendjes civile të mësipërm nëse ka.  
(Bashkëlidhni kopje origjinale ose të njësuar të aktit që bën ndryshimin.)

ç) Të dhëna të tjera (bashkëlidhni dokumentacionin):

Paraardhësit:  PO / JO

Bashkëshorti/bashkëshortja:  PO/JO

Fëmija/fëmijët:  PO / JO

Vëllai/motra:  PO / JO

Fëmijë vëllai/motre:  PO / JO

**KUJTESË:** Familjarët në shkallë më të parë sipas Kodit Civil përjashtojnë familjarët e tjerë.  
Lutemi caktoni detajet sipas gjendjes familjare.

d) Të parët: (plotësoni emër, mbiemër, datëlindje dhe lidhja më të ekzekutuarin padrejtësisht pa gjyq për motive politike).

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formuari.

*(Formular aplikimi për dëshmëpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

---

---

---

---

---

---

dh) Adresa për komunikim:

Shteti: \_\_\_\_\_

Komuna/bashkia/qyteti: \_\_\_\_\_

Rruga: \_\_\_\_\_

Pallati/nr. i shtëpisë: \_\_\_\_\_

Apartamenti: \_\_\_\_\_

Ose kutia postare: \_\_\_\_\_

Nënshkruaj me shkrim dorë çdo fletë të këtij formulari.



*(Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

IDENTITETI I APLIKUESIT KUR ËSHTË I NDRYSHËM NGA ISH-I DËNUARI

SEKSIONI II: *Të dhëna për (ekzekutimin)*

Lloji i ekzekutimit: Plotëso me kryq kutinë nëse para ekzekutimit, viktimja është dënuar me më shumë se një lloj dënimi, evidentojini të gjitha ato. Bashkëlidh dokumentacionin.

Ekzekutim pa gjyq:  koha kur \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ (dita/muaji/viti)

Mënyra e ekzekutimit dhe shkaku (shpjego me fjalë)

---

---

Burgim/heqje lirie:

Izolim në hetuesi:

Internim me tela me gjemba deri më 1954:

Internim/dëbim:

Izolim në institucion mjekësor:

Kryer më shumë se një dënim të të njëjtit lloj:

PO/JO

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*(Formular aplikimi për dëshmipërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

Nëse po gjatë dënimit kryer dënim tjetër në kohën e vuajtjes së dënimit:

PO / JO  (nuk duhen)

Përcakto periudhën/periudhat e kryerjes së dënimit tjetër politik para ekzekutimit dhe nëse është paraqitur kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë. (Këto rubrika plotësohen nëse viktimat ka kryer dënim tjetër politik përpara ekzekutimit pa gjyq):

#### BURGIM/HEQJE LIRIE

VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*(Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

VENDI: \_\_\_\_\_

hyrje \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_ dalje/transferuar \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_  
(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)

VENDI: \_\_\_\_\_

hyrje \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_ dalje/transferuar \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_  
(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)

VENDI: \_\_\_\_\_

hyrje \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_ dalje/transferuar \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_  
(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

IZOLIM NË HETUESI

VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

**INTERNIM NË KAMP ME RRETHIM ME TELA ME GJEMBA DERI MË 1954**

VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)

VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*Formular aplikimi për dëmshpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

INTERNIM/DËBIM

VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
	hyrje __ / __ / ____ dalje/transferuar __ / __ / ____
	(ditë/muaj/vit) (ditë/muaj/vit)

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

*Formular aplikimi për dëshmëpërblimin financiar të familjarëve të viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike. I vlefshëm brenda datës (6 muaj nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.)*

**IZOLIM NË INSTITUCION MJEKËSOR**

VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)
VENDI:	_____
hyrje	__ / __ / ____
dalje/transferuar	__ / __ / ____
(ditë/muaj/vit)	(ditë/muaj/vit)

Përlogaritja e dëshmëpërblimit

\_\_\_\_\_

Nënshkruaj me shkrim dore çdo fletë të këtij formulari.

**VENDIM**  
**Nr.942, datë 17.11.2010**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR MARRJEN E  
LEJEVE MINERARE NË ZONAT E HAPURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 29, pikat 1 e 11, 30 e 56, pika 1, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në një kërkesë për leje minerare në zonat e hapura, sipërfaqja e zonës së kërkuar duhet të ndodhet brenda sipërfaqes së zonave të publikuara si zona të hapura në planin vjetor mineral.

2. Dokumentacioni i plotë i kërkesës për një leje minerare paraqitet në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe data e aplikimit shpallet nga kjo qendër.

3. QKL-ja i përcjell në mënyrë elektronike Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentacionin e plotë të aplikimit për leje minerare dhe bën të mundur aksesin në këtë dokumentacion për institucionet shqyrtuese, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).

4. Vlerësimi i kushteve të lejimit dhe shqyrtimi i dokumenteve vërtetuese në kërkesat për leje minerare kërkim-zbulimi për grupet e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore dhe për grupin e mineraleve radioaktive, realizohen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), ndërsa kërkesat për leje minerare shfrytëzimi për grupet e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore, për grupin e mineraleve radioaktive dhe për lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, realizohen nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

5. Hartimi i aktit të miratimit të lejes minerare realizohet nga drejtoria përkatëse në ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare në Republikën e Shqipërisë dhe më pas miratohet nga Ministri.

6. Shqyrtimi i kërkesave për leje minerare për zonat e hapura bëhet në bazë të parimit “i pari në kohë, i pari në të drejta”, dhe akti i miratimit të ministrit i jepet subjektit që ka aplikuar i pari dhe ka plotësuar kushtet e lejimit dhe dokumentacionin shoqërues sipas pikës 10 të këtij vendimi.

7. Subjektet që aplikojnë për leje minerare të kërkim-zbulimit, të shfrytëzimit apo të kërkim-zbulim-shfrytëzimit, bashkë me dosjen e dokumentacionit për leje minerare, janë të detyruar të deklarojnë me shkrim burimin ligjor të të gjithë informacionit gjeologjik apo gjeologo-minerar, të përdorur në ndërtimin e dokumentacionit aplikues.

8. Aplikimi për një leje minerare shfrytëzimi ose leje minerare kërkim-zbulimi-shfrytëzimi ka përparësi ndaj aplikimit për një leje kërkim-zbulimi.

9. Kërkesat e paraqitura, ato në proces apo të papërfunduara, në kuptim të nenit 57 të ligjit nr.10 304, datë 1.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” do të quhen kërkesat që kanë realizuar aplikimin për leje mjedisore dhe kanë të miratuar nga institucioni i AKBN-së projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare, përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

10. Kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së këtyre kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, përcaktohen si më poshtë vijon:

A. Kërkesa për leje kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, si dhe për grupin e mineraleve ndërtimore dhe grupin e mineraleve radioaktive.

A.1 Aplikimi me dokumentacionin e plotë për një leje minerare kërkim-zbulimi bëhet pranë sporteve të QKL-së. Data e aplikimit të dokumentacionit të plotë është data e përlllogaritjes së afatit për miratimin e heshtur.



Dokumentacioni i plotë përmban:

a) Ekstraktin e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për regjistrimin si person juridik, ku në objektin e veprimtarisë të ketë të miratuar edhe zhvillimin e veprimtarisë minerare me punime sipërfaqësore ose nëntokësore, sipas kërkesës.

b) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit, të cilat i vlejné kërkuesit për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit, duke përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrimin e përvojës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka.

c) Kontratën me drejtuesin teknik të punimeve, të noterizuar, i cili duhet të jetë inxhinier i fushës së veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit sipas emërtimeve të universiteteve, vërtetuar me diplomën përkatëse.

ç) Një nga burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare të kërkim-zbulimit, si dhe/ose një nga vërtetimet për ekzistencën e tyre, si më poshtë vijon:

i) Një deklaratë nga banka që konfirmon se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku të këtë të depozituara të paktën 20% të vlerës së investimit, të parashikuar në programin e investimeve që ka paraqitur;

ii) Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke, ose subjekti tjetër financiar me vlerë, e cila mbulon investimet që parashikohen të kryhen;

iii) Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë rast, personi juridik duhet të paraqesë një dokument noterial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojné burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar/aksionar i vetëm, ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor maxhoritar).

d) Projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe programin minimal të punës për kërkim-zbulimin, që duhet të përmbajnë:

i) Format përshkruese të zonës minerare që përmban një hartë topografike të shkallës 1:25000 të zonës së kërkuar për leje kërkim-zbulimi, konturin vizatuar në hartë, koordinatat shtetërore në plan dhe sipërfaqen e saj.

ii) Specifikim të mineraleve ose grupet e mineraleve për të cilët kërkohet leja, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

iii) Një përshkrim të shkurtër gjeografiko-ekonomik të zonës së kërkuar për leje kërkim-zbulimi (relievi, klima, bimësia, hidrografia, hidrogeologjia, ekonomia, demografia, infrastruktura).

iv) Një përshkrim të shkurtër të ndërtimit gjeologo-tektonik të zonës nga të dhënat studimore arkivore, shoqëruar me hartën gjeologjike të saj në shkallë (1:10 000–1:50 000), historiku i studimeve dhe punimeve të kryera, rezultatet e tyre.

v) Një përshkrim për mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore, përshkrim më të plotë për mineralin apo mineralet për të cilët kërkohet leja. Vendburimet dhe objektet e njohura nga punimet e kërkim-zbulimit, vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim. Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre.

vi) Mënyra e propozuar e kërkim-zbulimit të mineraleve.

vii) Një përshkrim të programit të kërkim-zbulimit të propozuar me studime e punime, të projektuara në zonën e kërkuar për leje kërkim-zbulimi, të fazave të kryerjes së tyre sipas afateve (punime kërkimi, punime zbulimi), sipas llojeve të tyre (gjeologjike, gjeokimie, gjeofizike). Për punimet e kërkimit dhe të zbulimit të programuara duhet që studimi:

- të shoqërohet me projekt teknik për secilin nga sheshet, vendburimet apo objektet ku projektohet, ku të jepen argumentimi, lloji dhe vëllimi i punimeve që projektohen, të dhëna për koston e tyre, afatet e programuara të realizimit të tyre.

- të ilustron me materialin grafik, si: harta, projeksione, profile etj. në shkallën e duhur për secilin shesh, vendburim, objekt dhe punim të projektuar në fazën e aplikimit për leje kërkim-zbulimi.

viii) Një program minimal pune të kërkim-zbulimit të propozuar për t'u kryer në tërësi për lejen minerare dhe për secilin shesh, vendburim dhe objekt; me zërat e punimeve të programuara, vëllimin e tyre, shpenzimet e programuara për secilin zë dhe në tërësi. Ky program minimal pune të programohet për secilin vit pune të lejes minerare.

ix) Përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

x) Programi minimal i punës i propozuar për lejen e kërkim-zbulimit nuk duhet të jetë më i vogël në vlerë sesa produkti i sipërfaqes së kërkuar për leje me vlerën e caktuar monetare të shpenzohet për çdo kilometër katror të sipërfaqes, ky sipas tabelës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 14, pika 4, të ligjit minerar).

dh) Projektin e rehabilitimit të zonës minerare, që përfshin:

i) projektin e veprimtarive të mbylljes,

ii) projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare,

iii) projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare.

A.2 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar verifikon zonën e kërkuar minerare, harton një akt verifikimi, sipas formularit të përcaktuar në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi, realizon oponencën teknike dhe shqyrton në këshillin teknik projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit, programin minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare, dhe i dërgon Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendrike pas datës së aplikimit në QKL vendimin e miratimit ose të mosmiratimit të këshillit teknik të nënshkruar nga titullari i institucionit dhe sekretari i këshillit teknik.

A.3 Ministri, brenda një afati prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendrike nga data e aplikimit në QKL, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkim-zbulimit dhe të garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare. Brenda këtij afati, subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse mjedisore që mbulon zonën e kërkuar minerare. Në rast të mospajisjes me këtë leje, Ministri nxjerr aktin e refuzimit për pajisjen me leje minerare.

A.4 Lejet e kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve radioaktive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e Ministrit që mbulon veprimtarinë minerare. Në këtë rast, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

A.5 Kërkuesi njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

B. Kërkesa për leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore, për grupin e mineraleve radioaktive dhe për lejen e kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara

B.1. Aplikimi me dokumentacionin e plotë për një leje minerare shfrytëzimi ose leje minerare kërkim-zbulimi-shfrytëzimi, bëhet pranë sporteve të QKL-së. Data e aplikimit të dokumentacionit të plotë është datë e përlogaritjes së afatit për miratimin e heshtur.

Dokumentacioni i plotë përmban:

a) Ekstraktin e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për regjistrimin si person juridik, ku në objektin e veprimtarisë të këtij të miratuar edhe zhvillimin e veprimtarisë minerare me punime sipërfaqësore ose nëntokësore sipas kërkesës;

b) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit, të vlefshme për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit apo kërkim-zbulim-shfrytëzimit, përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrim të përvojës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka;

c) Kontratën me drejtuesin teknik të punimeve, të noterizuar, i cili duhet të jetë inxhinier i fushës së veprimtarive minerare të shfrytëzimit sipas emërtimeve të universiteteve, vërtetuar me diplomën përkatëse;

ç) Burimet financiare të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe vërtetime për ekzistencën e tyre që mund të jenë si më poshtë vijon:

i) Një deklaratë nga banka që të konfirmojë se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku duhet të ketë të depozituara të paktën 20% të vlerës së investimit, të parashikuara në programin e investimeve që ka paraqitur.

ii) Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke ose subjekti tjetër financiar, me vlerë, e cila mbulon investimet e parashikuara për t'u kryer.

iii) Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë rast personi juridik duhet të paraqesë një dokument noterial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar/aksionar i vetëm, ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor mazhoritar).

d) Projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe programin e investimeve për shfrytëzimin, të cilët duhet të përmbajnë:

i) Format përshkruese për zonën minerare që përmban një hartë topografike, të shkallës 1:25000, të zonës së kërkuar për leje shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi, konturin, vizatuar në hartë, koordinatat shtetërore në plan dhe sipërfaqen e saj.

ii) Specifikim të mineraleve ose grupeve të mineraleve, për të cilat kërkohet leja, sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

iii) Një plan rilevimi të zonës që kërkohet, me koordinatat përkatëse në plan, ndërtesat ekzistuese ose ndonjë objekt tjetër brenda zonës.

iv) Një përshkrim të shkurtër gjeografiko-ekonomik të zonës së kërkuar për leje kërkim-zbulimi (relievi, klima, bimësia, hidrografia, hidrogeologjia, ekonomia, demografia, infrastruktura).

v) Një përshkrim të shkurtër të ndërtimit gjeologo-tektonik të zonës nga të dhënat studimore-arkivore, shoqëruar me hartën gjeologjike të saj, në shkallë (1:10 000-1:50 000), historikun e studimeve e të punimeve të kryera, rezultatet e tyre.

vi) Një përshkrim për mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore apo rezultatet e kërkim-zbulimit, përshkrim të plotë për mineralin apo mineralet për të cilat kërkohet leja, për vendburimet dhe objektet e njohura nga punimet e kërkim-zbulimit, për vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim, për rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, për sasinë e cilësinë e tyre. Studimi të ilustron me materialin grafik, si: harta, projeksione, profile etj., në shkallën e duhur për secilin shesh, vendburim, objekt dhe punim të projektuar në fazën e aplikimit për leje shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi.

vii) Mënyrën e propozuar të shfrytëzimit dhe/ose të përpunimit të mineraleve.

viii) Një përshkrim të programit të shfrytëzimit dhe/ose të përpunimit të propozuar për t'u kryer që përfshin një plan pune, afatet, së bashku me shpenzimet e parashikuara që do të kryhen për realizimin e tij, metodat e propozuara të punës.

ix) Një plan pune investimi të propozuar për t'u kryer, që përfshin një plan pune, afatet, së bashku me shpenzimet e parashikuara për këtë program investimi që duhet të vlerësohet nga strukturat përgjegjëse dhe miratohet nga Ministri. Vlera e garancisë së investimit duhet të vlerësohet nga strukturat përgjegjëse dhe të miratohet nga Ministri.

x) Program të hollësishëm i shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të propozuar për t'u kryer, përfshin të dhëna për mineralin që do të kërkohet, metodat e propozuara të punës, mjetet që do të përdoren, afatet për zhvillimin e punimeve dhe investimet për realizimin e programit; një parashikim të hollësishëm të investimeve kapitale, të kostove të punës, të të ardhurave dhe tipin e parashikuara të burimeve financiare.

xi) Program pune të hollësishëm për rastin kur kërkohet përpunimi i mëtejshëm i mineralit, për objektet që do të ndërtohen, për mënyrën e trajtimit të mineraleve, e për treguesit e skemës së përpunimit.

xii) Raport teknik për shfrytëzimin, trajtimin e mineraleve me mundësitë e rritjes së vlerës së tyre në Shqipëri dhe qëllimin e kërkuarit në lidhje me to.

xiii) Të dhëna të hollësishme të operacioneve minerare të propozuara, duke përfshirë këtu:

- kapacitetin e llogaritur të prodhimit me shkallëzimin e operacioneve të punës;

- llojet e produkteve;

- propozimet për ndalimin e ndotjes, trajtimin e sterileve, mbrojtjen e pasurive natyrore, reklamimin dhe rehabilitimin progresiv të tokës së dëmtuar, të shkaktuar nga shfrytëzimi minerar dhe për minimizimin e efekteve të shfrytëzimit minerar mbi ujërat sipërfaqësore, të ujërave nëntokësore dhe tokave të zonave fqinje në zonën e lejuar;

- efektet që mund të ndodhin mbi mjedisin nga operacionet minerare dhe propozimet për minimizimin e tyre;

- ndonjë rrezik të veçantë (për shëndetin ose diçka tjetër) që mund të lindë gjatë shfrytëzimit të mineraleve dhe propozimet për kontrollin dhe eliminimin e tyre.

dh) Specifikime të propozimeve të tij për punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë.

e) Specifikime për kërkesat e pritshme të infrastrukturës dhe masave paraprake që do të ndërmerren, ku përfshihen, por jo vetëm, mënyra e hyrjes në zonën e lejuar për shfrytëzim minerar.

ë) Projektin e rehabilitimit të zonës minerare, që përfshin:

i) projektin e veprimtarive të mbylljes;

ii) projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare;

iii) projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare.

f) Përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

B.2 AKBN-ja verifikon zonën e kërkuar minerare dhe harton një akt verifikimi sipas formularit të përcaktuar në aneksin 4, bashkëlidhur këtij vendimi, realizon oponencën teknike, shqyrton në këshillin teknik projektin e zhvillimit të veprimtarive minerale të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, programin e investimit për shfrytëzimin ose kërkim-zbulim-shfrytëzimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe i dërgon Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL, vendimin e miratimit ose jo të këshillit teknik, të nënshkruar nga titullari i institucionit dhe sekretari i këtij këshilli.

B.3 Ministri, brenda një afati prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh kalendarike nga data e aplikimit në QKL, nxjerr aktin e miratimit ose të refuzimit të lejes së shfrytëzimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare. Brenda këtij afati subjekti duhet të pajiset me lejen përkatëse mjedisore që mbulon zonën e kërkuar minerare. Në rast të mospajisjes me këtë leje, ministri nxjerr aktin e refuzimit për pajisjen me leje minerare.

B.4 Lejet e shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare. Në këtë rast nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

B.5 Kërkuari njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës nëpërmjet publikimit në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

11. Pranimi i aplikimeve sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim fillon pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e programit 3-vjeçar minerar dhe të planit vjetor minerar.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Qendra Kombëtare e Licencimit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## ANEKSI 1

Formati përshkruet i një zone minerare të një leje kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore dhe grupin e mineraleve radioaktive, hartohet nga kërkuesi i lejes minerare dhe ka këtë përmbajtje:

Për zonën minerare që përfshin objektin: (*emri i objektit mineral*), në qarkun (*emri i qarkut/rrethit*) përfshirë në zonën e hapur nr.(*numri i zonës së hapur të shpallur në hartën e planit vjetor mineral*), të publikuar në hartën e zonave të hapura të planit vjetor mineral të vitit.....

a) Shoqëria, (*emri i shoqërisë sipas ekstraktit të QKR-së*) me administrator (*emri i administratorit*) me adresë (*adresa e shoqërisë*), kërkon të pajiset me leje minerare kërkim-zbulimi, për zonën minerare që përfshin objektin (*emri i objektit mineral*) për mineralin e (*emri/emrat e mineralit/mineraleve për të cilët kërkohet leja*), i cili/të cilët, bazuar në ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” i përket/përkasin grupit (*grupi i mineraleve*).

b) Koordinatat shtetërore në plan të zonës së kërkuar janë si në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.1

Koordinatat e pikave kufizuese të zonës së kërkuar

Nr.	Y	X
1		
2		
3		
4		
.		
n		

c) Sipërfaqja e zonës së kërkuar për kërkim-zbulim është ----km<sup>2</sup>.

d) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është në pronësi të (*shtetit, autoriteteve vendore, pronë private ose kombinim i tyre*) (*kjo pikë plotësohet nëse ka informacion nga ana e kërkuesit*).

e) Harta topografike në shkallë 1:25 000 me ngjyra, me konfigurim të dukshëm të sipërfaqes, tabelën e koordinatave shtetërore në plan të pikave kufizuese, si dhe sipërfaqen (bashkëlidhur).

Administratori i shoqërisë  
(Emër, mbiemër, firma, vula)

## ANEKSI 2

Akti i verifikimit për një leje kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore dhe grupin e mineraleve radioaktive hartohet nga institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe ka këtë përmbajtje:

### AKT VERIFIKIMI

**Për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore dhe grupin e mineraleve radioaktive**  
**Data ..... ora .....**

Për objektin: (*emri i objektit mineralar*), vendburimin e (*emri i vendburimit/masivit*) në qarkun (*emri i qarkut/rrethit*), përfshirë në zonën e hapur nr. (*numri i zonës së hapur të shpallur në hartën e planit vjetor mineralar*), të publikuar në hartën e zonave të hapura të planit vjetor mineralar të vitit.....

1. Shoqëria (*emri i shoqërisë sipas ekstraktit të QKR-së*), me administrator (*emri i administratorit*), me adresë (*adresa e shoqërisë*), ka realizuar kërkesën drejtuar institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në datën (*data dhe ora e aplikimit të kërkesës sipas publikimit në web site e SHGJSH*), për kryerjen e aktit të verifikimit për zonën minerare që përfshin objektin (*emri i objektit mineralar*) për t'u pajisur me leje minerare kërkim-zbulimi, për mineralin e (*emri/emrat e mineralit/mineraleve për te cilët kërkohet leja*), i cili/të cilët, bazuar në ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", i përket/përkasin grupit (*grupi i mineraleve*).

2. Nga vlerësimi i materialeve dokumentare, verifikimi në data base dhe verifikimi në terren i specialistëve të SHGJSH-së, i përbërë sipas rastit nga të paktën dy inxhinierë të fushës së kërkim-zbulimit të mineraleve rezulton se:

- a) Zona e kërkuar për zhvillimin e aktivitetit të kërkim-zbulimit *përfshihet/(nuk përfshihet)* brenda kontureve të përcaktuara në hartën e zonave të hapura të planit vjetor mineralar të vitit.....
- b) Koordinata e zonës së kërkuar janë si në tabelën mëposhtme.

Tabela nr.1

Koordinatat e pikave kufizuese të zonës së kërkuar.

Nr.	Y	X
1		
2		
3		
4		
.		
n		

c) Ato janë/(nuk janë) në përputhje me kërkesën e subjektit.

d) Sipërfaqja e zonës së kërkuar për kërkim-zbulim është ----km<sup>2</sup> dhe në përputhje/(jo në përputhje) me kërkesën e subjektit.

e) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është/(nuk është) e mbuluar nga ndonjë akt tjetër verifikimi për leje minerare (*nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën dhe orën e kërkesës për akt verifikimin*).

f) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është/(nuk është) licencuar më parë për aktivitetet kërkim-zbulimi, shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi (*nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën e lejes*).

g) Sipërfaqja e zonës së kërkuar (nuk) mbivendoset me: zonë (zona) të licencuar më parë dhe ku lejet minerare janë aktive (nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën e lejes).

h) Zona e kërkuar (nuk) ka lidhje me infrastrukturën rrugore.

i) Zona e kërkuar (nuk) ka lidhje me infrastrukturën elektrike, telefonike dhe elemente të tjera.

j) Në afërsi të zonës së kërkuar, që parashikohet t'i nënshtrohet kërkim-zbulimi (nuk) ndodhen ndërtesa banimi.

k) Operacionet e ndryshme të kërkim-zbulimit që do të zhvillohen (nuk) do të kenë efekte në objekte të ndryshme në sipërfaqe (nëse po, jep efektet e këtij aktiviteti).

l) Nga vlerësimi i zonës rezulton se në këtë zonë ka:

- pasuri natyrore;

- toka bujqësore, pyje, kullota;

- vepra të infrastrukturës, si: rrugë automobilistike, linja tensioni, vepra hidroteknike etj.;

- vendbanime, objekte social-kulturore, vepra arti etj., pasi pranë zonës së kërkuar nuk ndodhen të tilla;

- vepra të tjera të mbrojtura me ligj.

m) Brenda zonës së kërkuar (nuk) ka monumente të karakterit të ndashëm, historike, të trashëgimisë kulturore, gjeomonumente të arkeologjisë apo të tjera, të cilat mund të dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit minerar (nëse po, jep listo objektet).

3. Akti i verifikimit do të shoqërohet me:

a) Hartën topografike në shkallë 1:25000 me ngjyra me konfigurimin e sipërfaqes, tabelën e koordinatave shtetërore në plan të pikave kufizuese, si dhe sipërfaqen.

b) Planimetrinë e vendosjes së subjekteve të licencuara më parë, ose që kanë aplikuar për akt verifikimi përreth zonës së kërkuar për akt verifikimi.

4. Për sa më sipër, subjekti mund (nuk mund) të vazhdojë procedurat e mëtejshme për t'u pajisur me leje minerare kërkim-zbulimi në përputhje me ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e këtij vendimi.

Verifikimi u krye nga:

Ing.  
(emër, mbiemër, firma)

Ing.  
(emër, mbiemër, firma)

Ing.  
(emër, mbiemër, firma)

Titullari institucionit  
(emër, mbiemër, firma, vula)

Sekretari i këshillit teknik  
(emër, mbiemër, firma)

Shkrimi arial, 11.

### ANEKSI 3

Formati përshkrues i një zone minerare të një leje shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore, për grupin e mineraleve radioaktive dhe për lejen e kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara hartohet nga kërkuesi i lejes minerare dhe ka këtë përmbajtje:

Për zonën minerare që përfshin objektin: (*emri i objektit minerar*), në qarkun (*emri i qarkut/rrethit*) përfshirë në zonën e hapur nr. (*numri i zonës së hapur të shpallur në hartën e planit vjetor minerar*) të publikuar në hartën e zonave të hapura të planit vjetor minerar të vitit.....

a) Shoqëria (*emri i shoqërisë sipas ekstraktit të QKR-së*), me administrator (*emri i administratorit*), me adresë (*adresa e shoqërisë*) kërkon të pajiset me leje minerare shfrytëzimi / kërkim-zbulim-shfrytëzimi, për zonën minerare që përfshin objektin (*emri i objektit minerar*) për mineralin e (*emri/emrat e minerali/mineraleve për të cilët kërkohet leja*), i cili/të cilët, bazuar në ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i përket/përkasin grupit (*grupi i mineraleve*).

b) Koordinatat shtetërore në plan të zonës së kërkuar janë si në tabelën mëposhtme.

Tabela nr.1

Koordinatat e pikave kufizuese të zonës së kërkuar.

Nr.	Y	X
1		
2		
3		
4		
.		
n		

c) Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytëzim/kërkim-zbulim-shfrytëzim është ----km<sup>2</sup>.

d) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është në pronësi të (*shtetit, autoriteteve vendore, pronë private ose kombinim i tyre*) (kjo pikë plotësohet nëse ka informacion nga ana e kërkuesit).

e) Harta topografike në shkallë 1:25 000 me ngjyra, me konfigurim të dukshëm të sipërfaqes, tabelën e koordinatave shtetërore në plan të pikave kufizuese, si dhe sipërfaqen, (bashkëlidhur).

Administratori i shoqërisë  
(emër, mbiemër, firma, vula)



## ANEKSI 4

Akti i verifikimit për një leje për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore, për grupin e mineraleve radioaktive dhe për lejen e kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara hartohet nga institucioni i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe ka këtë përmbajtje:

### AKT VERIFIKIMI

**Për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet; për grupin e mineraleve ndërtimore, për grupin e mineraleve radioaktive dhe për lejen e kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara**

**Data ..... ora.....**

Për objektin: (*emri i objektit mineral*), vendburimin e (*emri i vendburimit/masivit*) në qarkun (*emri i qarkut/rrethit*) përfshirë në zonën e hapur nr. (*numri i zonës së hapur të shpallur në hartën e planit vjetor mineral*), të publikuar në hartën e zonave të hapura të planit vjetor mineral të vitit.....

1. Shoqëria (*emri i shoqërisë sipas ekstraktit të QKR-së*) me administrator (*emri i administratorit*), me adresë (*adresa e shoqërisë*), ka realizuar kërkesën drejtuar institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në datën (*data dhe ora e aplikimit të kërkesës sipas publikimit në web site e AKBN*), për kryerjen e aktit të verifikimit për zonën minerare që përfshin objektin (*emri i objektit mineral*) për t'u pajisur me leje minerare shfrytëzimi (*ose kërkim-zbulimi-shfrytëzim*), për mineralin e (*emri/emrat e mineralit/mineraleve për të cilët kërkohet leja*), i cili/të cilët, bazuar në ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë" i përket/përkasin grupit (*grupi i mineraleve*).

2. Nga vlerësimi i materialeve dokumentare, verifikimi në data base dhe verifikimi në terren i specialistëve të AKBN-së, i përbërë, sipas rastit nga të paktën dy inxhinierë të fushës së shfrytëzimit të mineraleve rezulton se:

a) Zona e kërkuar për zhvillimin e aktivitetit të shfrytëzimit përfshihet/(nuk përfshihet) brenda kontureve të përcaktuara në hartën e zonave të hapura të planit vjetor mineral të vitit.....

b) Koordinatat e zonës së kërkuar janë si në tabelën mëposhtme.

Tabela nr.1

Koordinatat e pikave kufizuese të zonës së kërkuar.

Nr.	Y	X
1		
2		
3		
4		
.		
n		

c) Ato janë/(nuk janë) në përputhje me kërkesën e subjektit.

d) Sipërfaqja e zonës së kërkuar për shfrytëzim (ose kërkim-zbulimi-shfrytëzim) është ---km<sup>2</sup> dhe në përputhje/(jo në përputhje) me kërkesën e subjektit.

e) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është/(nuk është) e mbuluar nga ndonjë akt tjetër verifikimi për leje minerare (*nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën dhe orën e kërkesës për akt verifikimin*).

f) Sipërfaqja e zonës së kërkuar është/(nuk është) licencuar më parë për aktivitetet kërkim zbulimi, shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi (nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën e lejes).

g) Sipërfaqja e zonës së kërkuar (nuk) mbivendoset me: zonë (zona) të licencuar më parë dhe ku lejet minerare janë aktive (nëse po, jep emrin e subjektit, numrin dhe datën e lejes).

h) Zona e kërkuar (nuk) ka lidhje me infrastrukturën rrugore.

i) Zona e kërkuar (nuk) ka lidhje me infrastrukturën elektrike, telefonike dhe elemente të tjera.

j) Në afërsi të zonës së kërkuar, që parashikohet t'i nënshtrohet shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi (nuk) ndodhen ndërtesa banimi.

k) Operacionet e ndryshme të shfrytëzimit ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi që do të zhvillohen (nuk) do të kenë efekte në objekte të ndryshme në sipërfaqe (nëse po, jep efektet e këtij aktiviteti).

l) Nga vlerësimi i zonës rezulton se në këtë zonë ka:

- pasuri natyrore;

- toka bujqësore, pyje, kullota;

- vepra të infrastrukturës, si: rrugë automobilistike, linja tensioni, vepra hidroteknike etj.;

- vendbanime, objekte social-kulturore, vepra arti etj., pasi pranë zonës së kërkuar nuk ndodhen të tilla;

- vepra të tjera të mbrojtura me ligj.

m) Brenda zonës së kërkuar (nuk) ka monumente të karakterit të ngjashëm, historike, të trashëgimisë kulturore, gjeomonumente të arkeologjisë apo të tjera, të cilat mund të dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit minerar (nëse po, jep, listo objektet).

3. Akti i verifikimit do të shoqërohet me:

a) Hartën topografike në shkallë 1:25000 me ngjyra, me konfigurimin e sipërfaqes, tabelën e koordinatave shtetërore në plan të pikave kufizuese, si dhe sipërfaqen.

b) Planimetrinë e vendosjes së subjekteve të licencuara më parë, ose që kanë aplikuar për akt verifikimi përreth zonës së kërkuar për akt verifikim.

c) Planimetrinë e vendosjes së objekteve të ndryshëm të infrastrukturës, rrugëve, linjave të tensionit, pasurive të trashëgimisë kulturore, pyje, kullota, pasurive natyrore apo veprave të tjera të mbrojtura me ligj.

4. Për sa më sipër, subjekti mund (nuk mund) të vazhdojë procedurat e mëtejshme për t'u pajisur me leje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi në përputhje me ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e këtij vendimi.

Verifikimi u krye nga:

Ing.

(emër, mbiemër, firma)

Ing.

(emër, mbiemër, firma)

Ing.

(emër, mbiemër, firma)

Titullari i institucionit

(emër, mbiemër, firma, vula)

Sekretari i këshillit teknik

(emër, mbiemër, firma)

Shkrimi arial, 11.

**Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.**

**Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.12.2010

Doli nga shtypi më 15.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT  
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë